


PROPOZIME PËR ULJEN E KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE DHE AVANCIMI I MËNYRËS SË ZBATIMIT TË TYRE



Shkup, mars 2021



Kingdom of the Netherlands

Edicion elektronik:

„Propozime për uljen e korrupsionit në prokurimet publike dhe avancimi i mënyrës së zbatimit të tyre“

Publikues:

Qendra për Komunikime Qytetare

Lektura:

Tatjana B. Eftimoska

Formulimi figurativ-grafik:

Polyesterday dooel, Skopje

Propozimet janë përgatitur në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike Llogaridhënëse” me ndihmën financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën prej 1 tetori 2019 deri më 30 shtator 2021.

PËRMBAJTJA

HYRJE

4

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

5

PROPOZIME PËR PËRFORCIMIN E INTEGRITETIT NË PROKURIMET PUBLIKE

7

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E PROCESIT TË ZBATIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

14

PROPOZIME PËR RRITJEN E TRANSPARENCËS NË PROKURIMET PUBLIKE

19

PROPOZIME NË DREJTIM TË IDENTIFIKIMIT DHE SANKSIONIMIT TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE

23

HYRJE

Problemi me korrupsionin në prokurimet publike i prek gjitha institucionet në vend, në nivelin lokal dhe kombëtar, por nevoja për të vendosur fokus në ndërmarrjet publike dhe shoqatat e aksionarëve të themeluar nga Qeveria dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) del nga një sërë argumentesh të rëndësishme. Numri i plotë i ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të themeluar nga Qeveria dhe NJVL në Republikën e Maqedonisë vlerësohet në 145 që do të thotë se ata paraqesin 10% të numrit të plotë të organeve kontraktuese të cilat janë të obliguar të zbatojnë prokurime publike (1.457 të regjistruar në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike). Vlera e plotë e marrëveshjeve të lidhura për prokurime publike të këtyre ndërmarrjeve në nivel vjetor është mes 250 dhe 300 milion euro që paraqet prej 30% deri 35% të vlerës së plotë të prokurimeve në vend. Me të drejtë pritet që organet kontraktuese të cilët zbatojnë prokurime publike në vlerë më të madhe të kenë edhe përgjegjësi më të madhe publike për zbatimin e politikave të forta dhe procedurave, si dhe për inkorporimin e mekanizmave të qëndrueshme për uljen e korrupsionit. Nga kjo, pikërisht këto organe kontraktuese siç janë ndërmarrjet më të mëdha publike dhe shoqatat aksionare të themeluar nga Qeveria por edhe nga njësitë për vetëqeverisje lokale duhet të jenë udhëheqës të përpjekjeve për parandalim dhe shkatërrim të korrupsionit në shpenzimet publike. Pritet që ulja e korrupsionit të ndërmarrjeve të themeluar nga Qeveria dhe nga NJVL drejtpërdrejtë do të ndikojë për rritjen e integritetit të gjithë ekonomisë në vend dhe të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Propozim-rekomandimet janë përgatitur me një hulumtim të thellë të rreziqeve nga korrupsioni, të sistematizuar në hulumtimin “Mapimi i rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike të ndërmarrjeve në pronësi të Qeverisë dhe të komunave”, si dhe me “screening” individuale të 37 ndërmarrjeve të themeluar nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe nga komunat e Gostivarit, Kavadar dhe Strugë, në të cilën është dhënë një pasqyrë e parametrave kryesore që reflektojnë mënyrën e zbatimit të prokurimeve publike, si dhe kapacitetet e kuadrove dhe politikat e brendshme të këtyre ndërmarrjeve.

Dobësitë e konstatuar me anë të hulumtimeve dhe analizave paraprahe të zbatuar e kanë konfirmuar nevojën e përforsimit të integritetit dhe uljes së rreziqeve nga korrupsioni në ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare.

Këto rekomandime janë të përgatitura në kuadër të projektit “Drejt ndërmarrje publike llogaridhënëse” të cilin e zbaton Qendra për Komunikime Qytetare me ndihmën financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup në periudhën 2019-2021 dhe ka për qëllim themelimin e mekanizmave të qëndrueshme për përmirësim të mënyrës së zbatimit të prokurimeve publike dhe për përforsim të integritetit në procesin e shpenzimit të mjeteve publike me anë të tenderëve në ndërmarrjet e Qeverisë, Qytetit të Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës.

Një pjesë e propozim-rekomandimeve që përmbahen në këtë dokument, Qendra për Komunikime Qytetare i ka dorëzuar edhe para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë muajit shkurt të vitit 2021 në procesin e përgatitjes së Planit të Veprimit të Qeverisë për luftën kundër korrupsionit.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Propozimet për uljen e korrupsionit në prokurimet publike dhe për avancimin e mënyrës së zbatimit të tyre janë të ndarë në katër segmente dhe atë propozime për përforcimin e integritetit në prokurimet publike, propozime për përmirësimin e procesit të zbatimit të prokurimeve publike, propozime për rritjen e transparencës së prokurimeve publike dhe propozime në drejtim të identifikimit dhe sanksionimit të korrupsionit në prokurimet publike.

Në drejtim të rritjes së integritetit të prokurimeve publike janë dhënë propozimet më poshtë:

- ◆ Ndërmarrjet publike dhe shoqatat e aksionarëve të themeluar nga Qeveria dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) të përgatitin plane për integritet me identifikim, analizë dhe prioritizim të rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike me zbatimin e indikatorëve për matjen e rreziqeve dhe përcaktim të masave për uljen e rreziqeve nga korrupsioni.
- ◆ Hartimi dhe zbatimi i politikave të qarta të brendshme (procedura, rregulla dhe udhëzime) për mënyrën e veprimit të nëpunësve të punësuar dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në gjitha fazat e procesit të prokurimeve në të cilat d të përfshihet edhe mënyra e veprimit në raste të denoncimit të korrupsionit në prokurimet publike.
- ◆ Zbatimi i parimit të rrotullimit të punësuarve si anëtarë të komisioneve për prokurime publike në ndërmarrjet më të mëdha publike dhe shoqata të aksionarëve të themeluar nga Qeveria dhe NJVL.
- ◆ Përgatitja dhe zbatimi i programeve përkatëse për edukim të vazhdueshëm profesional të punësuarve, përfshirë edhe temat mbi integritet, sjellje etike dhe parandalim të korrupsionit në procesin e prokurimeve publike.
- ◆ Zbatimi i analizave të brendshme periodike dhe konsekuent dhe vlerësime të rezultateve nga prokurimet e zbatuara publike të cilat do të përfshijnë gjitha segmentet dhe fazat e procesit të prokurimeve publike, duke filluar me planifikimin e prokurimeve deri në realizimin e plotë të kontratave, përfshirë edhe kontrollet e jashtme të zbatuara.

Në grupin e propozimeve për përmirësim të procesit të zbatimit të prokurimeve publike bëjnë pjesë:

- ◆ Të përmirësohet procesi planifikimit të prokurimeve publike edhe në kuptim të nevojës së lëndës për prokurim edhe në kuptim të vlerës përkatëse.
- ◆ Ankandi elektronik të zbatohet vetëm për produkte me cilësi të njohur dhe të standardizuar dhe për të cilat ka konkurrencë në tregun.
- ◆ Palët kontraktuese duhet të ulin në minimum mungesën e transparencës së procedurës me negociata pa publikimit paraprak të shpalljes, veçanërisht sepse shpesh e përdorin vetëm për negociata me një ofrues dhe nga këto rriten rreziqet nga korrupsioni.
- ◆ Respektimi i afatit të përcaktuar ligjor për miratimin e vendimit për përzgjedhje ose për anulim të procedurës, që nuk është rasti në pjesën më të madhe të procedurave të monitoruara të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare.
- ◆ Të mos përfundohet shpesh dhe lehtë me anulim të procedurës në baza të caktuara, dhe kur ajo të bëhet, të jepen arsyetime të hollësishme për të përcaktuar që anulimi është i arsyetueshëm.

Në drejtim të rritjes së transparencës së prokurimeve publike janë dhënë propozimet më poshtë:


- ◆ Intensifikimi i mënyrës transparente të komunikimit mes organit kontraktues dhe operatorëve ekonomik dhe shoqatat e tyre, posaçërisht me anë të zbatimit të shpeshtë të dialogut teknik dhe organizim të takimeve për sqarim.
- ◆ Procesverbalet nga hapjet publike të ofertave të jenë në dispozicion publikisht me anë të publikimit të tyre në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike.
- ◆ Zbatimi i drejtë i obligimeve nga Ligji për Prokurime Publike për publikim të njoftimit për kontratë të lidhur në afat prej 10 ditëve nga lidhja e kontratës dhe njoftim për kontratë të realizuar në afat prej 10 ditëve nga realizimi i plotë i kontratës.
- ◆ Organet kontraktuese të publikojnë në ueb faqet e tyre planin aktual për prokurime publike me gjitha ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, shpalljet për prokurime publike dhe njoftimet për kontrata të lidhura dhe të realizuara.

Në segmentin e identifikimit dhe sanksionimit të korrupsionit në prokurimet publike janë dhënë propozimet më poshtë:

- ◆ Byroja për Prokurime Publike të zgjerojë shtrirjen e kontrollit drejtues të procedurave për prokurime publike, gjegjësisht të zbatohen kontrole edhe të procedurave në bazë të vlerësimit të rreziqeve nga shkelja e dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike dhe të procedurave me zgjedhje të rastit.
- ◆ Me anë të ueb faqeve të organeve kompetente për hulumtim të veprave ndëshkimore dhe penale në fushën e prokurimeve publike dhe/ose për ndjekje të kryerësve, rregullisht të informohet opinioni në një mënyrë sistematike dhe të qartë për zhvillimin e rasteve.
- ◆ Në dokumentet e tenderimit në mënyrë të detyrueshme të përcaktohen persona të autorizuar për pranimin e denoncimeve për denoncim të brendshëm dhe të jashtë nga ana e informatorëve, dhe në lidhje me korrupsion në prokurimet publike.

Për të gjitha propozimet e dhënë është përgatitur sqarim, si dhe përshkrim i problemeve të cilat tejkalohen dhe qëllimet të cilat do të arrihen me zbatimin e tyre.

PROPOZIME PËR PËRFORCIMIN E INTEGRITETIT NË PROKURIMET PUBLIKE



SQARIM I PROPOZIMIT:

Planifikimi dhe zbatimi i prokurimeve publike në bazë të analizës paraprake të rreziqeve nga korrupsioni dhe masa të themeluara për uljen e tyre do të kontribuojë për uljen e korrupsionit, me anë të parandalimit dhe zbulimit më të lehtë.

Qeveria dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe themelues të ndërmarrjeve, duhet të japin nxitje dhe mbështetje për këtë proces. Gjatë kësaj, me të drejtë mund të pritet prezantimin e planeve për integritet të udhëheqin ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare, në të cilat vlera e plotës e prokurimeve publike në nivel vjetor është së paku 500.000 euro, dhe gjatë kësaj, këtë praktik të prezantojnë edhe ndërmarrjet tjera me vëllim më të vogël të prokurimeve. Planet për integritet në prokurimet publike mund të integrohen në planet vjetore për integritet në nivel të ndërmarrjes dhe duhet të bazohen mbi vlerësimin e vërtetë të rreziqeve nga korrupsioni.


Në kuadër të projektit “Drejt ndërmarrjeve publike llogaridhënëse” në hulumtimin e zbatuar në bazë të monitorimit të thellë të tenderëve të ndërmarrjeve. [Mapimi i rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike të ndërmarrjeve në pronësi të Qeverisë dhe komunave](#) janë identifikuar 15 lloje të rreziqeve në gjitha fazat e zbatimit të prokurimeve publike (planifikimi, zbatimi i procedurave për prokurime publike dhe realizim i kontratave). Për të lehtësuar procesin e përgatitjes dhe zbatimit të planeve për integritet, do të përgatitet edhe një manual i posaçëm i cili do të jetë në dispozicion ndërmarrjeve dhe themeluesve të tyre. Njëherë, procesi i përgatitjes së planeve do të lehtësohet edhe me vetë aktin e vendosjes së indikatorëve për matje të rreziqeve të korrupsionit, të cilat vetëm më janë prezantuar ndërmarrjeve shtetërore dhe themeluesit e tyre dhe janë të përputhura me gjitha palët e interesuara në fushën e prokurimeve publike.



PROBLEME QË TEJKALOHEJN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Paraqitja e rreziqeve të larta nga korrupsioni gjatë zbatimit të prokurimeve publike dhe mungesës së identifikimit të këtyre rreziqeve dhe masat për përballimin me ato, veçanërisht të identifikuar tek ndërmarrjet e mëdha dhe shoqatat tregtare shtetërore të cilat disponojnë me shuma të mëdha të dhe që janë në mesin e shpenzuesve më të mëdhenj me anë të prokurimeve publike.

Hulumtimi i zbatuar në ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare të themeluar nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës, në të cilat bëjnë pjesë shumë ndërmarrje, ka treguar që 70% prej tyre asnjëherë nuk kanë bërë vlerësim të rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike. Gjithashtu, 92% të tyre nuk kanë pasur trajnime për integritet dhe anti-korrupsion në prokurimet publike, as për të punësuarit, madje drejtimi. Asnjë prej këtyre ndërmarrjeve nuk ka plan për integritet në prokurimet publike. Këto të dhëna në mënyrë të drejtë flasin që në ndërmarrjet e themeluar nga Qeveria dhe nga NJVL nuk punohet në mënyrë sistematike të parandalimit dhe çrrënjësjes së korrupsionit në prokurimet publike. Kjo gjendje rezulton me pasivitet të plotë në përballimin me problemin e korrupsionit, që më mirë pasqyrohet në të dhënat që udhëheqjet e këtyre ndërmarrjeve gjatë 3 viteve të fundit nuk kanë nisur asnjë procedurë disiplinore për të punësuar në kuptim të problemeve të konstatuar në fushën e prokurimeve publike, madje edhe nuk kanë nisur iniciativë për fillim të procedurës penale për shkak të dyshimit për korrupsion në prokurimet publike.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Përgatitja e politikave të brendshme do të mundësojë që në mënyrë të qartë të përcaktohen obligimet e gjitha palëve të përfshirë në procedurat për prokurime publike edhe atë nga planifikimi i prokurimeve publike, me anë të zbatimit të procedurave, deri në realizimin e plotë të kontratave. Në këtë mënyrë do të sigurohet ndjekje të procesit të prokurimeve publike dhe do të mundësojë nivel të lartë të njohurisë së procedurave dhe rregullave nga ana e gjithë palëve të përfshirë në prokurimet publike, që është shumë e rëndësishme për të punësuarit që nuk janë nga fusha e prokurimeve publike, dhe marrin pjesë në komisionet për prokurime publike. Nevoja për përgatitjen e politikave të brendshme (procedurave, rregullave dhe udhëzimeve) për mënyrën e veprimit të nëpunësve të punësuar në gjitha fazat e procesit të prokurimeve publike që thekson edhe Enti Shtetëror për Revizion (ESHR).

Këto politika dhe procedura të brendshme do të mundësojnë saktësim dhe konkretizim të rregullave të caktuara për veprim, sjellje etike, do të përforcojnë integritetin dhe do të rrisin

përgjegjësinë në mesin e nëpunësve të punësuar. Nga kjo, në këto politika dhe akte të brendshme do të përmbahen rregulla dhe mënyra (sisteme) për përgatitjen e planit për prokurime publike, ndjekje të realizimit të planit për prokurime publike, dhe pastaj zbatim të procedurave, realizim të kontratave të lidhura për prokurime publike, si dhe për mënyrën e veprimit në raste të zbulimit ose denoncimit të korrupsionit në prokurimet publike.

Me të drejtë mund të pritet që këto politika të brendshme për mënyrën e veprimit të nëpunësve të punësuar dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në gjitha fazat e procesit të prokurimeve publike do të lehtësojnë edhe procesin e revizionit (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe gjithsesi do të mundësojnë institucionet të përfshirë në luftën kundër korrupsionit të identifikojnë mosrespektimin e mundshëm të këtyre procedurave me qëllim që të vendoset dobia personale para interesit publik.




PROBLEME QË TEJKALOHEJN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Pavarësisht nga dispozitat e Ligjit për Prokurime Publike të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit, si dhe Kodin e Sjelljes gjatë Zbatimit të Prokurimeve Publike, sërisht ka shumë shembuj të padrejtësive dhe sjellje korruptuese në zbatimin e prokurimeve publike në gjitha fazat e procedurës, nga përcaktimi i nevojave për prokurimet dhe planifikimin e prokurimeve, në zbatimin e procedurës, deri në realizimin e kontratave për prokurime publike.

Sipas hulumtimit të bërë me 37 ndërmarrje të themeluar nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës, një rregullore për veprim në fushën e prokurimeve publike me të cilin janë të njoftuar të gjithë të punësuarit në prokurimet publike kanë marrë vetëm gjysma e ndërmarrjeve publike të përfshira dhe shoqata aksionare. Nga kjo, në gjysmën e këtyre organeve kontraktuese do të duhet të miratohen këto politika dhe rregullore, ndërsa në gjysmën e dytë do të duhet që përputhen me propozime të dhënë. Në hulumtimin e zbatuar, një pjesë e madhe e ndërmarrjeve pohojnë që kanë sistem të themeluar për ndjekjen e realizimit të planeve për prokurime publike (78% e ndërmarrjeve të anketuara), si dhe për realizimin e kontratave të lidhura për prokurime publike (84% e ndërmarrjeve të anketuara). Megjithatë, monitorimi i drejtpërdrejtë i prokurimeve publike në këto ndërmarrje nuk ka konfirmuar zbatimin e vërtetë të procedurave për ndjekjen e zbatimit të planeve për prokurime publike dhe të kontratave të lidhura.

Ndryshe, vetë ndërmarrjet publike dhe shoqatat e aksionarëve, në pyetjen për problemet kryesore, i kanë theksuar këto më poshtë: mungesë e kuadrit të mjaftueshëm profesional në fushën e prokurimeve publike, edukim i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe mungesë e dëshirës për të qenë anëtar i komisionit për prokurime publike, dilema rreth zbatimi të procedurave, ndryshimi i shpeshtë i ligjeve që vështirëson zbatimin e tyre në praktikë, lëvizje e dobët dhe komunikim me Byronë për Prokurime Publike në lidhje me çështjet dhe dilemat e parashtruara nga organet kontraktuese, etj.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Në politikat e brendshme të procesit të prokurimeve publike, rrotullimi i të punësuarve duhet të jetë një prej pyetjeve kryesore të cilat do të shqyrtohet në mënyrë përkatëse. Gjatë kësaj, duhet të përcaktohen kriteret e qarta për emërimin e anëtarëve të komisionit dhe situata, si plotësim i atyre vetëm më të identifikuar në Ligjin për Prokurime Publike, të cilat do të konsiderohen si konflikt potencial i interesave ose rrezik për subjektivizëm të shprehur të nëpunësve të emëruar. Për shembull, një person nuk mund të emërohet si anëtar i komisionit për lëndë të prokurimit për të cilën edhe viteve më herët ka qenë anëtar i komisionit, dhe lënda e prokurimit vazhdimisht është dhënë operatorit të njëjtë ekonomik.

Ky propozim mund të zbatohet në ndërmarrjet më të mëdha dhe shoqata aksionare të cilat kanë më tepër persona të përfshirë në prokurimet publike dhe në përgjithësi numër më të lartë të nëpunësve të punësuar të cilët zbatojnë detyra administrative pune.




PROBLEME QË TEJKALOHE / QËLLIME QË ARRIHEN:

Në më tepër se tre të katërt të ndërmarrjeve publike dhe shoqata aksionare, anëtarët e komisionit për prokurime publike ndryshohen për çdo procedurë të prokurimit publike. Duke marrë parasysh që vetëm gjysma e ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare kanë rregullore për veprim në fushën e prokurimeve publike, del që për ata të cilët nuk kanë këtë rregullore, rrotullimi i të punësuarve zbatohet si një rregull e pashkruar, gjegjësisht një praktikë shumëvjeçare, që gjithsesi mund të ndryshohet shumë lehtë.

Me zbatimin e këtij propozimi do të shmangen ose do të ulen mundësitë për marrëveshje të palejuar mes ofruesve dhe anëtarëve të komisioneve për prokurime publike – rrezik që ekziston nëse në komisionet çdoherë bëjnë pjesë personat e njëjtë. Gjithashtu, do të kufizohen edhe kompetencat duke pamundësuar akumulim të kompetencave në vendin e njëjtë të punës ose të punësuar të njëjtë.

Parimi i rrotullimit të anëtarëve të komisioneve për prokurime publike është i një parim i njohur dhe i pranuar në praktikën e mirë botërore, të cilët promovojnë edhe shumë organizata të njohura ndërkombëtare (p.sh. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim – OECD) ose organe kombëtare (për shembull, Enti Shtetëror i Statistikës) në drejtim të uljes së rreziqeve nga keqpërdorimi.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Gjatë përgatitjes së planeve vjetore për trajnim në nivel të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare, si dhe gjatë përcaktimit të planeve individuale për kualifikime profesionale për secilin të punësuar që ka pika të ngjashme me prokurimet publike (persona për prokurime publike, anëtar i komisioni për prokurime publike, person i përfshirë në përpunimin e dokumentimit të tenderimit ose në realizimin e kontratës së lidhur) duhet të parashikohen vizita të ngjarjeve edukative për prokurime publike, por edhe të atyre që nuk janë drejtpërdrejtë të lidhur me prokurimet publike. Në këtë kontekst, ndonëse numri i vogël i dispozitave në Ligjin për Prokurime Publike në kuptim të punës etike, parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave që në thelb tregojnë që punohet edhe për një segment më të vogël dhe të parëndësishëm të prokurimeve publike, sërish, rëndësia e tyre është e madhe, dhe deri më tani dhe është injoruar si zakonisht. Prandaj, duhet të organizohen së paku njëherë në vit trajnime dhe ngjarje tjera edukative në këtë temë ose të ngjashme, që nuk do të përfshijë vetëm kornizën ligjore, por edhe situata të caktuara praktike.

Intensifikimi i trajnimeve për punë etike, parandalimi i korrupsionit dhe konfliktin e interesave mund të arrihet në disa mënyra, edhe atë me anë të:

- ◆ Përpunimi i moduleve të veçanta në kuadër të programit për edukim të nëpunësve për prokurime publike në qendrën e trajnimit të Byrosë për Prokurime Publike,
- ◆ Organizimi i trajnimeve të veçanta jashtë programit të rregullt për edukim të nëpunësve për prokurime publike, të cilat gjithashtu kanë mundur të organizohen me anë të qendrës së trajnimit të Byrosë së Prokurimeve Publike, dhe
- ◆ Organizimi i in-house trajnimeve nga ndërmarrjet publike dhe shoqatave aksionare.




PROBLEME QË TEJKALOHE / QËLLIME QË ARRIHEN:

Madje 92% të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të analizuar nuk zbatojnë trajnime për integritet dhe anti-korrupsion, si për të punësuarit, ashtu edhe për drejtimin dhe anëtarët e bordit. Pothuaj se 8% të tyre zbatojnë këtë lloj të trajnimeve së paku njëherë në vit, por jo për drejtimin, ndërsa 5% zbatojnë çdo vit për të punësuarit, dhe në disa vite, edhe për drejtimin.

Këto trajnime kontribuojnë për rritjen e vetëdijes për rreziqet kundër integritetit, siç janë korrupsioni, mashtrimi dhe diskriminimi, si dhe ndaj përfitimit të njohurive për mënyrat e parandalimit të rreziqeve dhe krijimit të kulturës së ndërtimit të integritetit si pendë e korrupsionit.

Ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare konsiderojnë që një numër i madh i trajnimeve do të jenë të dobishme për personat e përfshirë në prokurimet publike. Mes tjerave, i theksojnë trajnime për ngritje të njohurisë së kuadrit, trajnime për përdorime praktike të Ligjit për Prokurime

Publike, trajnime praktike për zgjidhjen e problemeve konkrete, trajnime për anti-korrupsion, për përfitim të shkathtësive për planifikim më të mirë të mjeteve, përpunimi i planit për prokurime publike, trajnime praktike për përgatitjen e dokumentacioneve për tenderim, trajnime të synuar për personat teknike si të bëjnë kritere më të mira dhe mënyrë të notimit dhe tjera të ngjashme.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Në politikat, rregullat ose procedurat e brendshme për prokurime publike, detyrimisht të parashikohet që vetë organi kontaktues, gjegjësisht personat për prokurim publik ose ekip i përcaktuar i veçantë do të zbatojnë analiza të brendshme periodike dhe të vazhdueshme dhe vlerësime të rezultateve nga prokurimet publike të zbatuara. Më e rëndësishme, nevoja për zhvillimin e analizave nuk duhet vetëm të theksohet në letër, por edhe të zbatohet në praktikë. Analizat duhet të jenë të gjithëpërfshirës dhe të analizojnë çështjet në të cilat rreziku për korrupsion është më i lartë, edhe atë:

- ◆ realizimi i planit për prokurime publike – arsye për ndryshime dhe përqindja e realizimit,
- ◆ konkurrenca në procedurat e zbatuara për prokurime publike – numri mesatar i ofruesve për procedurë në të cilat është fituar një ofertë dhe është pranuar një ofertë,
- ◆ shpërndarja e tenderëve të dhënë sipas operatorëve ekonomik,
- ◆ çmimet dhe shpenzimet e plota – sa çmimet e fituara dhe çmimet me të cilat janë lidhur kontratat përputhen me vlerën mestarë dhe me vlerën mesatare të çmimeve në treg,
- ◆ tenderë të dhënë pa publikim të shpalljes – analizë e arsyeve për përfundim me këto procedura,
- ◆ procedura të anuluar – analizë më e thellë të arsyeve për anulim, gjegjësisht a janë objektive ose mund të përcaktohen organit kontraktues,
- ◆ procedura të apeluar – arsye për apelimin dhe rezultati nga procedura e apelit,
- ◆ zbulime të kontrolleve të zbatuara administrative nga ana e Byrosë për Prokurime Publike, dhe
- ◆ respektimi i obligimeve dhe masave të brendshme për transparencë.

Një segment i veçantë të cilit duhet të dedikohet një vëmendje është konkurrenca në procedurat për prokurime publike. Analiza duhet të tregojë për cilat lëndë të prokurimit ka konkurrencë (3 ose më tepër oferta) dhe për ato që nuk ka konkurrencë (nuk ka asnjë ofrues ose më së shumti dy ofrues). Në këtë kontekst, duhet të analizohen arsyet për konkurrencën e dobët dhe sa mungesa ose numri i vogël i ofertave për lëndë konkrete të prokurimit përputhet me numrin në nivelin kombëtar për këtë lëndë të prokurimit. Nëse mungesa e konkurrencës për një lëndë të caktuar të prokurimit është karakteristike vetëm për këtë lloj të organeve kontraktuese, analiza duhet të gjejë arsyet (organi kontraktues për shkak të sasive të vogla që siguron ose vonesa me pagesat nuk është tërheqës për ofruesit, kriteret e rrepta për aftësi nuk mundësojnë konkurrencë, para-detajet ose specifikimet e gjera teknike i refuzojnë ofruesit, paraqitja e shoqërimit në kartel të ofruesve, etj.). Nga analiza duhet të dalin masa konkrete për përmirësimin e konkurrencës që mund të jenë: ndarja e kohës më të gjatë dhe resurseve për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, përfshirë edhe konsultimin paraprak të tregut me anë të zbatimit të dialogut teknik dhe përfshirje të personave të jashtëm profesional, eliminim të kriterëve për aftësi të cilat kanë shkaktuar kufizimin e konkurrencës, përcaktim të periudhës më të gjatë të parashtrimit të ofertave, etj.

Këto analiza, të cilat do të përmbajnë vlerësim të suksesit në prokurimet publike dhe masa për përmirësimin e procesit që duhet të dorëzohen para themeluesve të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare në pronësi shtetërore.



PROBLEME QË TEJKALOHEJN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Aspektet problematike në prokurime publike, të cilat janë të pranishme edhe tek ndërmarrjet publike dhe shoqata aksionare të monitor janë konkurrenca e dobët (numri i vogël i ofruesve për procedurë) dhe përqendrimi i kontratave të lidhura në vetëm disa ofrues. Gjatë kësaj, organet kontraktuese pothuaj se nuk bëjnë analizë për të identifikuar arsyet e paraqitjes së kësaj dukurie dhe dobësive tjera dhe anomalive në produktivet publike të zbatuara.


Madje 73% të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare nuk e ndjekin konkurrencën e procedurave të prokurimeve publike që i zbatojnë, dhe nga kjo, nuk kanë në dispozicion informacione për numrin mesatar të ofertave të tenderëve në nivel vjetor, madje edhe për pjesën e tenderëve në të cilat kontratat janë lidhur me vetëm një ofertë të fituar.

Pothuaj se 40% të tenderëve që ishin lëndë e monitorimi, dhe që janë zbatuar nga ana e ndërmarrjeve dhe shoqatave aksionare të analizuar është dorëzuar vetëm një ofertë. Numri mesatar i ofertave të këtyre ndërmarrjeve dhe shoqatave aksionare është 2.5 oferta për procedurë dhe është nën mesataren kombëtare për vitin 2019 që ishte 3.3 oferta për procedurë. Konkurrenca e vogël konfirmon paraqitjen e diskriminimit në prokurimet për të cilën dëshmojnë edhe shembujt konkrete për përdorimin e kriterëve të papërshtatshme për përcaktimin e aftësisë së ofruesve, specifikat e favorizuara teknike dhe kriteret për zgjedhje të ofertës më të volitshme. Konkurrenca e vogël tregon për rrezik të paraqitjes së kushteve kufizuese në procedurat, ose, nëse këto elemente nuk kanë ekzistuar, tregon për mosbesim të ofruesve që procesi i përzgjedhjes është objektiv dhe i paanshëm.

Përqendrimi i prokurimeve publike në një operator ekonomike, si një prej indikatorëve më relevant për paraqitjen e rrezikut nga korrupsioni, është një problem që është evidentuar në numrin më të madh të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të analizuar. Në pothuaj se një të tretën e tyre, përqendrimi i prokurimeve në një kompani është më i lartë se 40 %.

Analizat do të nxitin drejtuesit e ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të miratojnë vendime strategjike për prokurime publike dhe do të lehtësojnë këtë proces. Më saktë, analizat do të lehtësojnë vlerësimin e mënyrave të plotësimit të nevojave të reja, gjegjësisht planifikimi dhe zbatimi i prokurimeve të reja publike.

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E PROCESIT TË ZBATIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE



SQARIM I PROPOZIMIT:

Duke u udhëhequr sipas rregullave të përmbajtura në Ligjin për Prokurime Publike, veçanërisht në lidhje me atë se cilat lëndë dhe në cilat situata nënshtrohen procedurave për prokurime publike dhe periudhat e nevojshme të për të përgatitur dhe përfunduar lloji i caktuar i procedurës për prokurime publike, organet kontraktuese duhet të miratojnë metodologji ose udhëzime për vlerësimin e nevojës së prokurimit konkret publike dhe vlerën përkatëse. Nga ky aspekt, organet kontraktuese nuk duhet të jenë të lidhur vetëm me kontratat paraprake të lidhura për një ose lëndë të ngjashme të prokurimit. Duhet të përdorin SEPP si një bazë e pasur e të dhënave për prokurime të zbatuara në territorin e gjithë shtetit dhe informacionet e gatshme publike në internet.

Më e rëndësishme është planifikimi, si një hap i parë në një proces, dhe të del nga hapi i fundit i procesit paraprak. Kjo do të thotë që analiza e zbatuar e brendshme të procedurës paraprake të zbatuar dhe kontrata e realizuar për lëndën e njëjtë ose të ngjashme të prokurimit duhet të mundësojë vlerësim më të mirë të prokurimit të ri (a është e nevojshme dhe kur është e nevojshme, në çfarë sasi dhe për çfarë periudhe, sa mjete janë të nevojshme, etj.).



PROBLEME QË TEJKALOHEIN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Gjatë vitit 2019, vetëm 8% të gjithë ndërmarrjeve publike dhe shoqata aksionare të analizuar nuk e kanë ndryshuar planin për prokurime publike. Gjatë kësaj, 49% të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare kanë bërë prej një deri më tre ndryshime të planeve, ndërsa 43% të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare kanë pasur më tepër se tre ndryshime dhe plotësime. Përveç kësaj, madje edhe planet që shpesh ndryshohen nuk realizohen në mënyrë të drejtë. Realizimi mesatar i planeve të ndërmarrjeve publike dhe shoqata aksionare në vitin 2019 është vetëm 54%. Vetëm 6% të tyre kanë përqindje të lartë të realizimit të planeve. Duhet të merret parasysh që planet për prokurime publike i miratojnë bordet drejtuese ose bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare. Nga kjo, realizimi i dobët i planeve për prokurime publike rrit edhe rrezikun nga subjektiviteti, dhe me atë, edhe korrupsionit, në përzgjedhjen se cilat tenderë do të zbatohen dhe cilat nuk zbatohen.

Përveç këtyre, tre të katërt të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare pohojnë që kanë themeluar sistem për ndjekjen e realizimit të planit për prokurime publike. Një prej e tyre kanë shërbim të veçantë operativ për këtë qëllim, tjerët, nga ana tjetër, mbajnë analiza të hollësishme në MS Excel tabela me të cilat ndjekin dhe evidentojnë realizimin e planit, dhe tjerë, të tretë, bordet drejtuese vendosin si do të jetë realizimi.

Vetëm dy ndërmarrje publike dhe shoqata aksionare kanë metodologji/manual ose dokument të ngjashëm në bazë të cilës njehsojnë vlerën e caktuar të prokurimeve.

Ndryshimet e shpeshta të planit për prokurime publike dhe mungesa e sistemit për ndjekje të realizimit flasin për planifikimin e dobët të prokurimeve publike dhe për drejtimin joefikas të mjeteve publike. Në pak raste të caktuara, ndryshimet mund të arsyetohen me rrethana objektive lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare. Për shembull, ndërmarrja nuk i ka realizuar të ardhurat e planifikuara ose nuk ka mundur të zbatojë veprimin në vëllim të plotë, dhe për këtë nuk ka pasur nevojë për lëndë të prokurimit ose nëse ka pasur nevojë, nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiar për të marrë. Por, në shumicën e rasteve, planet ndryshojnë, sepse gjatë hartimit fillestar të tyre nuk është kushtuar mjaft vëmendje për të përcaktuar nëse ka nevojë dhe mundësi nga prokurimi konkret dhe të vlerësohet vlera përkatëse, dhe më shpesh problemi arrin në atë që nuk është menduar në afatin e mesëm në kuptim që nga disa aktivitete ose ngjarje të caktuara do të del nevoja për prokurimin e lëndës së caktuar.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Duhet që ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare të zbatojnë e-ankandin në përputhje me praktikën e mirë botërore, përfshirë edhe recitalet e Direktivës së Bashkimit Evropian për Prokurime Publike të vitit 2014. Në fakt, e-ankandet duhet të zbatohen vetëm për mallra të konsumit të gjerë, gjegjësisht me cilësi të njohur dhe të standardizuar dhe të cilat në mënyrë shumë të saktë mund të përshkruhen në specifikimet teknike.


Përveç kësaj, e-ankandet kanë efekt për lëndë të prokurimit për të cilat ka konkurrencë në tregun që pasqyrohet edhe në prokurimet publike. Për këtë lëndë të prokurimit mund të pritet oferta, gjegjësisht ulje të çmimeve të para të dhëna nga ana e ofruesve.



PROBLEME QË TEJKALOHEH / QËLLIME QË ARRIHEN:

Ndonëse me Ligjin për Prokurime Publike të ri e-ankandi është bërë zgjedhore, edhe më tutje një numër i madh i prokurimeve (rreth 90% në vitin 2020), parashikohet si hapi vijues në fazën e vlerësimit të ofertave. Ajo që nuk përputhet me praktikën botërore, gjegjësisht e-ankandi të zbatohet atje ku ka konkurrencë të vërtetë dhe ku specifikimet teknike janë shumë të saktë. Faktet plasën që edhe tek ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare të monitoruara edhe në nivel të gjithë shtetit, konkurrenca në prokurimet publike është e dobët. Madje më shumë, me anë të kontrollit të numrit të lartë të specifikimeve teknike, mund lehtë të përfundohet që në pika të shkurta dhe të pasaktë e përshkruajnë lëndën e prokurimit.

Përdorimi intensiv i e-ankandit është një detyrë nga Ligji për Prokurime Publike paraprak, i mbjellë thellë tek nëpunësit për prokurime publike. Gjithashtu, këmbëngula e vazhdueshme e zhvillimit të e-ankandit duhet të jetë sinjal për organet udhëheqëse në institucionin për rrezik të rritur të keqpërdorimeve në procesin e prokurimeve publike dhe nxitjen e marrëveshjes mes kompanive.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Organi kontraktues çdoherë kërkon mendim nga Byroja për Prokurime Publike për zbatimin e procedurave me negociata pa publikim të shpalljes për bazat për të cilat Byroja për Prokurime Publike është kompetente për të dhënë mendime. Nëse Byroja ka dhënë mendim negativ në lidhje me zbatimin e procedurës me negociata, organi kontraktues duhet të respektojë atë mendim. Gjithashtu, organi kontraktues të mos kalojë në përdorimin e kësaj procedure pa mendimin e Byrosë për Prokurime Publike, ndonëse ligji në raste të jashtëzakonshme e lejon edhe atë.




PROBLEME QË TEJKALOHEH / QËLLIME QË ARRIHEN:

Ndonëse Ligji për Prokurime Publike madje më tepër i ka ulur bazat për zbatimin e procedurës me negociata pa publikimin e shpalljes, edhe më tutje kjo është shumë e pranishme. Një e treta e ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare të monitoruar kanë zbatuar procedura jo transparente pa publikimin e shpalljes. Në një pjesë e tyre, shumica e këtyre prokurimeve në vlerën e plotë të prokurimeve është prej 22% deri më 28%. Kjo shumë është shumë më e lartë nga mesatarja kombëtare për vitin 2019 që ka qenë 4,1 %.

Në veçanti problematike në kuptim të paraqitjes së rrezikut nga korrupsioni janë dy bazat në vijim: 1) negociata pa publikimin e shpalljes në bazë të urgjencës së fundit dhe 2) negociata në bazë që prokurimin mund të bëjë vetëm një operator ekonomik. Ndonëse për zbatimin e procedurës sipas këtyre dy bazave është e nevojshme nga Byrja për Prokurime Publike, dhe vetëm në situata të caktuara mund të fillohet me këtë procedurë dhe pas asnjë mendim nga Byroja, dhe çdoherë kjo procedurë jo-transparente hap mundësi për korrupsion.

Numri më i vogël i procedurave me negociata pa publikim të shpalljes do të rrit transparenten në procedurat dhe do të nxisin konkurrencën.



SQARIM I PROPOZIMIT:


Kur të përcaktohet afati për parashtrimin e ofertave të mos merret çdoherë afatin minimal që e përcakton Ligji për Prokurime Publike për këtë lloj të procedurës. Pavarësisht që lënda për prokurim është me vlerë më të vogël dhe me atë afatet për parashtrim të ofertave mund të jenë më të shkurtë, duhet të merren parasysh gjitha rrethanat objektive dhe të vlerësohet perioda e vërtetë e nevojshme për organin kontraktues të merr vendimin për zgjedhje ose anulim të procedurës për prokurim publik.



PROBLEME QË TEJKALOHE / QËLLIME QË ARRIHEN:

Mungesa e vendimit për zgjedhje ose anulim në afatin e përcaktuar me ligj është një shkelje për të cilën shqiptohet gjobë personit përgjegjës. Me vendosjen e afateve të shkurta për parashtrimin e ofertave, organet kontraktuese me vetëdije sjellin veten në situatë të mos të mund të respektojnë afatin për miratimin e vendimit, gjegjësisht në situatë për të shkelur Ligjin për Prokurime Publike. Nëse kësaj i shtojmë që këto shkelje nuk sanksionohen, krijohet një praktikë dhe jepet një sinjal që shkelja e dispozitave ligjore mund të kalohet edhe pa ndëshkim, gjegjësisht bëhet ndonjë gradim të shkeljeve që sanksionohen dhe shkeljet që do të tolerohen.

Miratimi i vendimit në afatin ligjor do të mundësojë operacionalizim të parimeve të ekonomisë dhe efikasitetit të prokurimeve publike. Njëherë, do të jepet shembull që secili obligim ligjor ka peshën e vet dhe duhet të respektohet.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Në mesin e bazave ligjore për anulim të procedurës për prokurime publike janë edhe dy bazat vijuese: 1) me vlerësimin e organit kontraktues që dokumentacioni i tenderimit përmban lëshime të mëdha ose mangësi dhe 2) për shkak të rrethanave të paparashikuara dhe objektive nevojat e organit kontraktues janë ndryshuar. Duke marrë parasysh që nga gjitha bazat ligjore për anulim të procedurës, në këto dy, veçanërisht në të parin, ka një dozë të subjektivizmit dhe hapësirë për manipulim në kuptim të shmangies së miratimit të vendimit me të cilën ofruesi i zgjedhur nuk është ai që është favorizuar, duhet të jepen argumente të hollësishme dhe mbështetje me dëshmi në vendimin dhe në njoftimin për anulimin e procedurës.




PROBLEME QË TEJKALOHEN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Në vitin 2019 norma e anulimit të procedurave për prokurime publike në nivel të gjithë shtetit ishte mesatarisht 27%. Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve publike dhe shoqata aksionare të analizuara kanë nivel të lartë të tenderëve të anuluar, që, sipas Byrosë për Prokurime Publike, paraqet një "flamur i kuq" për të treguar paraqitjen e rrezikut nga korrupsioni. Më saktë, 22% e ndërmarrjeve publike dhe shoqata aksionare kanë pasur normë madje edhe më të lartë të procedurave të anuluar në krahasim me mesataren kombëtare, ndërsa 78% janë nën mesataren.

Me uljen ose pamundësimin e anulimit të procedurave në raste kur ofruesi i favorizuar nuk mund të zgjidhet, ulet edhe korrupsioni në prokurimet publike. Nga ana tjetër, arsyetimet e hollësishme gjatë përdorimit të bazave të caktuara për anulim të procedurës do të kontribuojnë për rritje të transparencës dhe llogaridhënies së organit kontraktues.

PROPOZIME PËR RRITJEN E TRANSPARENCËS NË PROKURIMET PUBLIKE



SQARIM I PROPOZIMIT:

Ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare duhet më shpesh të praktikojnë dialog teknik, të cilin me Ligjin për Prokurime Publike të ri është mënyrë zgjedhore për konsultim të operatorëve ekonomik. Kjo formë e komunikimit mes organit kontraktues dhe ofruesve potencial duhet të zbatohet gjatë përgatitjes së prokurimeve më të mëdha nga vlera, por kryesisht tek prokurimet e planifikuara, por kryesisht për prokurime të planifikuara, pavarësisht nga vlera e tyre, për të cilat organi kontraktues nuk e njeh gjendjen dhe pjesëmarrësit e tregut ose lëndë e të cilës prokurimi është i ndërlikuar, gjegjësisht përshkrimi që zhvillohet nga organi kontraktues nuk ka mjaft profesionalizëm.


Takimet për sqarim duhet të rregullohen me Ligjin për Prokurime Publike si formë zgjedhore e komunikimit mes organit kontraktues dhe ofruesit potencial pas publikimit të shpalljes, dhe deri në afatin e parashtrimit të pyetjeve. Në këto takime organi kontraktues i fton gjithë operatorët e interesuar për të sqaruar procedurën dhe lëndën e prokurimit deri sa shpallja është ende e hapur. Procesverbali me pyetjet dhe përgjigjet e takimit për sqarim publikohen hapur që mos të ketë diskriminim mes operatorëve ekonomik të cilët kanë marrë pjesë në takimin dhe ata të cilët nuk kanë marrë pjesë.



PROBLEME QË TEJKALOHEN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Në anketën e zbatuar mes ndërmarrjeve publike shoqatave aksionare, vetë ata si probleme kryesore theksojnë mungesën e njohurisë profesionale për përpunim të specifikimeve teknike me të cilat do të pamundësohet marrja e ofertave me produkte jociësore ose shërbime ose specifikime me të cilat do të eliminohet konkurrenca vetëm më e vogël për prokurime të caktuara specifike. Përveç kësaj, në mostrën e monitoruar, ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare nuk e kanë përdorur dialogun teknik si mënyrë për tejkalimin e këtij problemi. Më saktë, dialogu teknik ishte përdorur vetëm në 4% të procedurave.

Me përdorimin e dialogut specifik organi kontraktues më mirë do të kuptojë tregjet, gjegjësisht specifikat e mallrave, shërbimeve dhe punëve që ofrohen (çmime, kushte dhe specifikime...). Me zbatimin e takimeve për sqarim, ofruesit potencial më mirë do të kuptojnë nevojat e organeve kontraktuese dhe kushtet për pjesëmarrje në procedurat.



SQARIM I PROPOZIMIT:


Procesverbalet nga hapjet publike të ofertave duhet të vendosen në dispozicion për gjithë opinionin, jo vetëm atyre që kanë marrë pjesë në procedurën (ofruesit). Për këtë qëllim, duhet të bëhet përditësim i SEPP me të cilin opinioni i gjerë do të ketë qasje dhe kontroll në procesverbalet nga hapjet publike që i bashkëlidh Komisioni për Prokurime Publike.



PROBLEME QË TEJKALOHEJN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Në hapjen publike të ofertave hapen ofertat dhe lexohen vetëm emrat e ofruesve dhe çmimet e tyre dhe garancitë eventuale të kërkuara dhe të dorëzuara të ofertave. SEPP nuk ofron mundësi që opinioni të mësojë informacionet themelore (ofrues konkret dhe çmime) për secilën procedurë, sepse njoftimet për kontratë të lidhur ose për anulim të procedurës përmban vetëm informacion agregat për numrin e ofruesve dhe çmimet më të ultë dhe më të lartë të ofruar.

Me anë të publikimit të hapur të procesverbaleve, palët e interesuara dhe opinioni më i gjerë do të njoftohet me operatorët ekonomik të cilët kanë marrë pjesë në procedura konkrete për prokurime publike dhe me atë prokurimet do të jenë nën një vështirësi tjetër, dhe do të pamundësohet marrëveshja paraprake e kompanive. Publikimi i hapur i procesverbaleve ekziston në platformën kroate elektronike për prokurime publike.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Plotësimi dhe publikimi i dy njoftimeve në afate është përcaktuar me ligj, andaj, për zbatimin e këtij propozimi nuk janë të nevojshme intervenime ligjore, por:

- ◆ themeluesit e ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare në pronësi shtetërore është të tregojnë personave përgjegjës për respektimin e këtij obligimi ligjor, dhe
- ◆ të përdoren sanksione të përcaktuara me Ligjin për Prokurime Publike për shkeljen e obligimit në lidhje me publikimin e njoftimeve për kontratë të lidhur dhe të njoftimeve për kontratë të realizuar.


Nëse edhe pas denoncimeve dhe sanksioneve edhe më tutje këto obligime nuk respektohen në mënyrë të drejtë, atëherë siç është në SEPP, është konfiguruar që mos të mund të publikohet shpallje e re për prokurim publik nëse pas skadimit të një periudhe kohore nga procedura e përfunduar për prokurim publik nuk është publikuar njoftim për kontratë të lidhur, si dhe për njoftim të pa publikuar për kontratë të lidhur të mos mund të publikohet shpallje e re për prokurim publik.



PROBLEME QË TEJKALOHEN / QËLLIME QË ARRIHEN:

Obligimi për publikimin e njoftimeve për kontrata të lidhura dhe realizuara është e rregulluar me ligj dhe është shumë e thjeshtë për zbatim, gjegjësisht nuk kërkon dedikimin e kohës dhe resurseve. Nga kjo, nuk janë të qarta arsyet për të cilat disa ndërmarrje publike dhe shoqata aksionare të caktuar për prokurime të theksuara i publikojnë njoftimet me vonës ose aspak nuk i publikojnë.

Me respektimin e këtyre obligimeve ligjore, nga njëra anë, organet kontraktuese në fjalë do të tregojnë që dëshirojnë të punojnë dhe të punojnë në përputhje me ligjin, dhe nga ana tjetër do të kontribuojë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e prokurimeve publike, dhe nga kjo, edhe besimi i qytetarëve dhe të përdoruesve të shërbimeve në ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare në pronësi shtetërore.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Në ueb faqet e tyre, ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare të vendosin një pjesë të veçantë për “prokurime publike” në të cilën rregullisht do të publikojnë dhe përditësojnë të dhënat për planin e prokurimeve publike me gjitha ndryshimet dhe plotësimet, shpalljet për prokurime publike dhe njoftimet për kontrata të lidhura dhe të realizuara.




PROBLEME QË TEJKALOHEM / QËLLIME QË ARRIHEN:

Ndonëse të gjitha këto informacione publikohen në SEPP, ueb faqet e organeve kontraktuese janë pasqyra e transparencës së tyre dhe prandaj në një vend të këtillë që vizitohet nga opinioni i gjerë duhet të vendosen në dispozicion edhe këto të dhëna. Në momentin, sipas rezultateve të hulumtimit, praktikë për të publikuar të dhënat për prokurimet publike në ueb faqet e tyre kanë vetëm 11% të ndërmarrjeve publike dhe shoqatave aksionare në pronësi shtetërore.

Me zbatimin e këtij propozimi organi kontraktues në mënyrë plotësuese do të rrit transparencën dhe do të mundësojë të interesuarve në më tepër vende në internet të arrijnë në informacionet e kërkuara.

PROPOZIME NË DREJTIM TË IDENTIFIKIMIT DHE SANKSIONIMIT TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE



SQARIM I PROPOZIMIT:

Byroja për Prokurime Publike, në përputhje me Nenin 172, Paragrafi 4 i Ligjit për Prokurimit Publik, në praktikë të zgjerojë shtrirjen e kontrollit administrativ, gjegjësisht të bëhen kontrolle dhe procedura në bazë të vlerësimit të rreziqeve të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike (a.q. “flamuj të kuq”) ose të procedurave me zgjedhje të rastit. Duke marrë parasysh që Byroja nuk ka kompetencë për të përcaktuar parregullsi të caktuar që janë rezultat i gabimit të paqëllimshëm ose me qëllim që të favorizohet një operator i caktuar ekonomik (kanë veti të veprës penale), duhet që me zbulimet e kontrollit administrativ me kohë të informohen prokuroritë kompetente publike edhe atë në mënyrë duke respektuar edhe Nenin 172, Paragrafin të Ligjit për Prokurime Publike.



PROBLEME QË TEJKALOHEN / QËLLIME QË ARRIHEN:


Në përputhje me Nenin 172 të ligjit, ka dy baza për kontrollin administrativ të Byrosë për Prokurime Publike:

- ◆ për gjitha tenderët e mallrave dhe shërbimeve mbi 500.000 euro dhe për tenderë të punëve ndërtimore mbi 2.000.000 euro, dhe
- ◆ për çdo procedurë të prokurimit publik në bazë të vlerësimit të rreziqeve nga shkelja e dispozitave të këtij ligji dhe me zgjedhje të rastit.

Me gjitha kontrollet administrative të zbatuar deri më tani janë përfshirë procedurat për prokurime publike që kanë shumën e vlerësuar mbi 500.000 euro për prokurim të mallrave dhe shërbimeve dhe mbi 2 milion euro për prokurim të punëve. Byroja për Prokurime Publike deri më tani nuk ka bërë kontroll në bazë të dy bazave tjera ligjore.

Për një të tretën e procedurave të prokurimeve publike që kanë qenë lëndë e kontrollit administrativ, Byrja për Prokurime Publike ka përcaktuar parregullsi në zbatimin e tyre. Ky është indikator i mjaftueshëm që kontrolli duhet të përfordhet.

Me kontrollet e përfordhuara do të ndikohet mbi uljen e korrupsionit në prokurimet publike. Me zbatimin e kontrolleve sipas dy bazave tjera do të përfshihen edhe procedurat për prokurim publik të cilat nuk janë me shumë aq të madhe, por sipas parametrave të dhënë në SEPP ka indikacione për shkelje të mundshme të Ligjit për Prokurime Publike dhe aktivitete korruptuese.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Të gjitha organet kompetente për hulumtim të veprave ndëshkimore dhe penale në fushën e prokurimeve publike dhe/ose për ndjekje të kryerësve, kryesisht Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, kanë ueb faqen dhe në këto, ndonëse janë dhënë informacione agregate për raste që kanë ndjekur, duhet rregullisht të informohen opinionin në një mënyrë sistematike dhe monitoruese për rrjedhjen e rasteve konkrete. Kjo do të thotë se kur veprimi për një rast ka kaluar në fazën vijuese, në organ tjetër kompetent, organi që e ka pasur lëndën deri në atë moment, edhe më tutje publikon informacione për statusin e rastit konkret.




PROBLEME QË TEJKALOHE / QËLLIME QË ARRIHEN:

Perceptimi i përgjithshëm, i mbështetur me hulumtime të shumta të zbatuar nga organizata të njohura, është që në prokurimet publike ka korrupsion të pranishëm. E vetmja që dallon është perceptimi i shkallës së korrupsionit. Sipas hulumtimeve të fundit të zbatuar nga QKQ në vitin 2019 dhe 2020, 48% të operatorëve ekonomik të analizuar kanë deklaruar që në prokurimet publike ka korrupsion.

Ndonëse është i lartë numri i procedurave për prokurime publike në të cilat ka pasur indikacione të qarta për aktivitete korruptuese, shumë pak raste kanë marrë përfundimin në gjyq, gjegjësisht sanksionim të kryerësve. Në secilën fazë vijuese në identifikimin dhe sanksionimin e kryerësve uljet numri i rasteve, gjegjësisht nëse për një numër të procedurave publike paralajmërohen hetime, për një pjesë të tyre zbatohen dhe një pjesë të hetimeve të zbatuara rezultojnë me akuzë të caktuar, që në fund vetëm disa procedura gjyqësore të marrin epilogun në formë të aktvendimit gjyqësor me sanksione të shqiptuara dhe kryera.

Me zbatimin e këtij propozimi do të rritet transparencia, llogaridhënia dhe në fund efektiviteti i procedurave ndëshkimore dhe penale për vepra lidhur me prokurimet publike. Me atë do të eliminohet perceptimi i përgjithshëm që ndjekja e kryerësve të veprimeve korruptuese është çdoherë e pasuksesshme.



SQARIM I PROPOZIMIT:

Ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare duhet të përshtatin modelet e formularëve të dokumentacioneve të tenderimit që i përdorin, gjegjësisht në ato, detyrimisht të përfshihen edhe të dhënat për personat e autorizuar për pranimin e denoncimeve për denoncim të jashtëm dhe të brendshëm nga ana e informatorëve.

Nëse praktika tregon që ndërmarrjet publike dhe shoqatat aksionare nuk zbatojnë deri në fund këtë propozim, atëherë Byroja për Prokurime Publike, si organ që përpunon modele të dokumentacioneve të tenderimit duhet që të bëjë plotësim të këtyre për të inkorporuar këtë informacion dhe të bëhet standarde.



PROBLEME QË TEJKALOHEM / QËLLIME QË ARRIHEN:

Deri më tani, ka një numër të vogël të denoncimeve për parregullsi, qenë ajo në formë të ankesës së parashtruar në Komisionin Shtetëror për Ankesa për Prokurime Publike (vetëm 8% nga kompanitë asnjëherë nuk kanë parashtruar ankesë në komision) ose në formë të denoncimit në institucione tjera kompetente (Komisioni Shtetëror për Parandalim të Komisionit, MPB, Prokuroria Publike, etj.). Përveç numrit të vogël të denoncimeve, ka zbulime për përhapjen e gjerë të korrupsionit në prokurimet publike. Kjo gjendje e imponon nevojën e promovimit të mekanizmave të denoncimit të parregullsive dhe korrupsionit në prokurimet publike, siç është mekanizmi i informatorëve. Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve i përfshin në kategori të peronave që mund të paraqiten si informatorë, mes tjerave, edhe personat që në çdo bazë ose relacion afarist ose lidhje bashkëpunimi janë me institucionin, gjegjësisht me personin juridik, për të cilin bën denoncimin. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e institucioneve ka persona për pranimin e denoncimeve nga informatorët.

Me zbatimin e këtij propozimi do të rritet dukshmëria e mekanizmit të informatorëve dhe do të nxitet zbatimi në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit në prokurimet publike. Ky propozim është përfshirë edhe në Propozim Strategjinë Kombëtare për Luftë kundër Korrupsionit që është dorëzuar për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

